



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E PROJEKTIMIT URBAN**

Elbasan më / 2025

**SPECIFIKIME TEKNIKE**

**TE OBJEKTIT : RIPARIM DHE LYERJE TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË  
BASHKINE E ELBASANIT PER VITIN SHKOLLOR 2025-2026**

## **SEKSION 1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME**

1.1 Specifikime të përgjithshme

1.1.1 Njësitë matëse

1.1.2 Punime të gabuara

1.1.3 Tabelat njoftuese

1.2 Dorëzimet te Supervizori

1.2.1 Autorizimet me shkrim

1.2.3 Mostrat

## **SEKSIONI RIFINITURAT**

2.1 Rifiniturat e mureve

2.1.1 Suvatimi i brendshëm

2.1.2 Lyerje me gëlqere dhe bojë

2.1.3 Skeleritë

## SEKSION I SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

### 1.1 Specifikime të përgjithshme

#### 1.2.2 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m<sup>2</sup>, m<sup>3</sup>, Km, N (Njuton), dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “. “.

Kontraktuesi duhet t'i japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervizori, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve.

#### 1.1.3 Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

#### 1.1.4 Tabelat njoftuese

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përvçë:

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përbajnë informacion të dhënë nga Supervizori dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

### 1.2 Dorëzimet te Supervizori

#### 1.2.1 Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim ” do t'i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervizori të dërguara kontraktuesit që përbajnë instrukSIONE, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

#### 1.2.2 Dorëzimet tek supervizori

Kontraktori duhet t'i dorëzojë Supervizorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t'i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime.

### 1.2.3 Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesorëve dhe tema të tjera që mund të kerkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim.

Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit.

Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe libreza e masave

Kontraktori do t'i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune

## SEKSIONI 2 RIFINITURAT

### 2.1 Rifiniturat e mureve

#### 2.1.1 Suvatimi i brendshëm

Sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç cimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe riforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim me drejtues i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard M-25 me përmbajtje për  $m^2$ : rërë e larë 0,005  $m^3$ ; llaç gëlqereje M- 1 : 2, 0.03  $m^3$ ; cimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m ), dhe e lëmuar me mistri e bërdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

#### 2.1.2 Lyerje me gëlqere dhe bojë

Gërryerja dhe heqja e bojatisjeve të vjetra me bojë dhe gëlqere të bardhë dhe me shumë shtresa mbi mure dhe tavane.

Stukimin dhe lëminin e suvase së re ose te rrashinuar më pare me stuko sintetike për të patur të gatshme dhe në menyrë perfekte sipërfaqet për lyerje.

Një dore solucion lidhes i formuar me rrëshire të hollë me 50% uje dhe e zbatuar me penel mbi mure dhe tavane.

Bojatisje me tre duar, me qumësht gëlqere për mure të brendëshme, të jashtme dhe tavane me dozature per  $m^2$ : gëlqere e shuar kg 0.55, pluhur ngjyre kg 0.01 si dhe cdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e plete te punes ne menyre perfekte.

Procesi i lyerjes së sipërfaqeve të mureve dhe tavaneve kalon nëpër dy faza si më poshtë:

#### 1-Pregatitja e sipërfaqes qe do te lyhet

Para lyerjes duhet te behet kruarja e ashper e bojes se meparshme nga sipërfaqja e lyer, mbushja e gropave apo demtimeve te sipërfaqes se murit me ane te stukimit me material sintetik dhe berja gati per paralyerje.

Përpara fillimit te procesit te lyerjes duhet te behet mbrojtja e sipërfaqes se murit qe nuk do te lyhen ( dyer, dritare e tj.) me ane te vendosjes se letrave mbrojtese.

#### 2-Paralyerja e sipërfaqes së pastruar

Në fillim te proçesit te lyerjes, behet paralyerja e sipërfaqeve te pastruara mire me gelqere te holluar (astari). Për paralyerjen behet perzierja e 1 kg gelqere me një liter uje. Me perzierjen e perqatitur behet paralyerja e sipërfaqes vetem me një dore. Norma e përdorimit është 1 liter gëlqere e holluar që duhet të përdoret për 2 m<sup>2</sup> sipërfaqe.

#### 3-Lyerja me bojë plastike e sipërfaqeve të jashtme.

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës plastike e cila është e paketuar në kuti 5 litërshe. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje I hidhet pigmenti derisa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizioni I punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar.

Norma e përdorimit është 1 litër bojë plastike e holluar duhet të përdoret për 4-5 m<sup>2</sup> sipërfaqe.

Kjo normë varet ashpërsia e sipërfaqes së lyer.

Personeli, që do të kryejë lyerjen duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes të KTZ dhe STASH.

Fugat nëpër qoshe dhe lidhje të mureve duhet të mbushen me ndonjë masë elastike (si psh silikon). Për secilën sipërfaqe 30 m<sup>2</sup> të veshur me pllaka të ndryshme, është e nevojshme vendosja e fugave lëvizëse.

### 2.1.3 Skeleritë

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STAZH. Një skelator kompetent dhe me ekspencence, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i Jane kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skeles. Skeleritë duhen të janë gjate kohës së perdorimit të përshtarshme për qellimin për të cilin do përdoren dhe duhet të janë konform te gjitha kushteve teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rruges ku ka kalim si te kalimtareve, ashtu edhe te makinave, duhet te merren masa që të bëhet një rrethim i objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eleminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skeleri çeliku te tipit këmbalec, konform KTZ dhe STAZH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartesi mbi 12 m, elementët horizontale duhet të kenë parmake vertikale, me lartesi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjete.

Skeleri çeliku në kornize dhe e lidhur, konform KTZ dhe STAZH, duke përfshirë ndihmën për

transport, mirëmbajje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontale duhet të kenë parmake vertikale, me lartesi min. 15 cm si dhe mbrojtjen me rrjete.

**Punoi:**

Ing. Teuta Tepelena

Ing. Bruno Korumi

Ing. Amarildo Ahmati

**Drejtor I D.P. U**

**ark. Marvis Avllazagaj**

**MIRATOI**

**KRYETARI BASHKISË**

**Gledian LLATJA**

